



Kodi ynë i Sjelljes
Veprojmë si duhet



Përbajtja

Një mesazh nga Margherita	3	Pajtueshmëria me ligjin	25	Privatësia	43
Pse e kemi “Kodin e Sjelljes”	4	Marrëveshjet e brendshme	26	Angazhimi ynë për privatësinë	44
The Digital Vodafone Way	5	Ligjet e Konkurrencës	27	Parimet e privatësisë	45
Vendimmarrja etike	6	Parandalimi i pastrimit të parave	28	Si t'i zbatoni “Parimet tonë të privatësisë”	46
Çfarë do të thotë kjo për mua?	7	Sanksionet	29		
Speak up	8	Kontrollet e tregtisë	30		
Çfarë do të thotë kjo për mua?	10	Shëndeti dhe siguria	31	Diversiteti dhe përfshirja	48
Sjellja individuale	11	Rregullat absolute	33	Parandalimi i ngacmimit dhe shqetësimeve	50
Mitmarrja dhe pagesat e papranueshme	12	Fushat elektromagnetike (EMF)	34	Komunitetet dhe shoqëria	51
Konfliktet e interesit	14	Droga dhe alkooli	35		
Dhuratat dhe mikpritja	16	Integriteti financiar	36	Mjedisi	53
Udhëtimet dhe shpenzimet	18	Angazhimi në kontrata dhe shpenzime	38		
Menaxhimi i të dhënave dhe dokumenteve tonë	19	Zbatojmë një rrjet furnizimi të përgjegjshëm	39	Përkufizime	56
Siguria	20				
Klasifikimi dhe mbrojtja e informacionit	22	Politika dhe komunikimet publike	40		
Marka jonë	23	Të flasësh në emër të Vodafone	41		
Të drejtat e pronësisë intelektuale (DPI)	24	Përdorimi i medias sociale	42		

Një mesazh nga Margherita

Qëllimi ynë është të lidhemi për një të ardhme më të mirë dhe jam shumë krenare për punën që bëjmë së bashku.

Është e quartë se Vodafone duhet të ndryshojë për t'u rritur dhe për të qenë një operator telekomunikacioni i shkëlqyer në Evropë dhe Afrikë. Ne kemi nevojë për tregje të fuqizuara dhe agile që janë të përqendruara tek klientët tanë dhe duhet të thjeshtojmë mënyrën se si operojmë. Megjithatë, ajo që nuk do të ndryshojë është angazhimi ndaj Qëllimit tonë dhe përbajtja e Kodit të Sjelljes Vodafone. Ju lutemi sigurohuni që ta lexoni dhe ta kuptioni atë.

Secili prej nesh ka një zë për t'u dëgjuar!
Nëse keni shqetësimë, procesi ynë "Speak Up" është në dispozicionin tuaj.

Faleminderit,

Margherita Della Valle
Vodafone Group Chief Executive Officer



Të punosh në mënyrën e Vodafone do të thotë që ne duhet të veprojmë gjithmonë me integritet për t'u siguruar që kemi besimin e Klientëve, kolegëve, partnerëve tanë të biznesit dhe komuniteteve me të cilët ne punojmë.

“Kodi ynë i Sjelljes” përcakton se çfarë presim ne nga secili person që punon për dhe me Vodafone. Gjithashtu, thekson përgjegjësinë tonë ndaj njerëzve, partnerëve dhe aksionerëve.

“Kodi i Sjelljes” na ndihmon ne të gjithëve të marrim vendime të informuara dhe na udhëzon se ku duhet të kërkojmë për më shumë informacion.

“Besimi qëndron në themel të çdo gjëje që bëjmë.”

Reth Parimeve tona të Biznesit

“Parimet tona të Biznesit” janë themeli se si ne kryejmë biznesin kudo që ne punojmë dhe ato qëndrojnë në thelb të “Kodit tonë të Sjelljes”. Këto parime jepen të hijëzuara në fillim të çdo kapitulli të “Kodit të Sjelljes”.

Çfarë është “Kodi i Sjelljes”?

“Kodi i Sjelljes” është dokumenti bazë i politikave tona, në të cilin përcaktohen kërkesat që duhet të respektojë çdo person që punon për dhe me Vodafone, pavarësisht vendndodhjes. Natyrishq që ju mund të keni dhe politika të tjera shtesë të cilat duhet t'i zbatoni që janë specifike për rolin ose tregun tuaj lokal.

Për kë është “Kodi i Sjelljes”?

“Kodi ynë i Sjelljes” është për të gjithë ata që punojnë për dhe me Vodafone: të punësuarit, drejtoret, kontraktorët, filialët, bashkëpunëtorët dhe furnitorët. Ne presim që furnitorët dhe partnerët tanë të biznesit t'u përbahen të njëjtave standarde dhe të respektojnë Kodin tonë të Blerjes Etike.

Cilat janë pasojat nëse nuk e zbatoni?

Ka pasoja shumë serioze nëse nuk zbatoni Kodin tonë të Sjelljes. Ne mund të ndërmarrim masa disiplinore por mund edhe t'i pushojmë njerëzit nga detyra kur është e nevojshme.



The Digital Vodafone Way

The Digital Vodafone Way përcakton vlerat tona themelore se si ne të punojmë që të admirohem nga klientët, aksionerët, njerëzit me të cilët ne punojmë dhe në komunitetet ku ne punojmë.

Admiration			
Customer Obsessed <ul style="list-style-type: none">• Immerses self in customer experience, hands-on with products• Takes accountability for personalised customer experience• Uses external radar to understand customer and product trends	Digital Vodafone <ul style="list-style-type: none">• Hungry for innovation, embraces creativity, experimentation and risk taking – fail fast, learn fast and scale fast• Throws self into new technology• Makes data and AI driven decisions• Adopts agile ways of working such as; prototyping mindset, collaborative, cross-functional, design thinking, lean	Ambitious & Competitive <ul style="list-style-type: none">• Sets high expectations for self and others• Is a life-long student (a 'learn-a-lot'), continuously develops self, has a curious mind• Strives to outperform competitors, looks beyond internal benchmarks	One Company Local Roots <ul style="list-style-type: none">• Collaborates with others, both internal and external (within broader eco-system)• Actively seeks, shares and adopts best practices• Makes best decisions for Vodafone as a whole
Speed <ul style="list-style-type: none">• Prioritises the right things, is focused• Demonstrates sense of urgency for self and others• Analyses, decides and executes fast	Simplicity <ul style="list-style-type: none">• Communicates clearly, straightforwardly and coherently• Develops 'easy to use' solutions (processes, products, interfaces etc.) for our customers/employees• Challenges conventional ways of working, simplifies and/or eliminates work	Trust <ul style="list-style-type: none">• Do what you say you will do• Trusts others to deliver• Supports decisions once made	
Admired Leader			
<ul style="list-style-type: none">• Creates 'purposeful' direction, generates engagement	<ul style="list-style-type: none">• Empowers, coaches, and holds to account	<ul style="list-style-type: none">• Builds capacity through talent, diverse teams and a lean & effective organisation	<ul style="list-style-type: none">• Demonstrates ownership mentality and behaviours

Vendimmarrja etike

Përballë zgjedhjeve të vështira, ndonjëherë mund të jetë e vështirë të bëni gjënë e duhur. Mund të përdorni mjetin e mëposhtëm të vendimmarrjes për të ndihmuar veten ose ekipin tuaj kur përballeni me vendime të vështira.

Për t'ju ndihmuar të vendosni nëse po veproni drejt, duhet t'i bëni vetes këto pyetje:



Mendoni



Pyesni



Veproni



A është ligjore
dhe etike?



A është në përputhje
me "Kodin" tonë?



A është gjëja e duhur
për klientët tanë?



A do të ishit
krenarë po t'ua
tregonit të
tjerëve
veprimet tuaja?

Nëse ju përgjigjet me "jo" cilësdo prej këtyre pyetjeve, ose nëse nuk jeni të sigurt, duhet të ndaloni dhe të kërkonit këshilla ose të konsultoheni me pjesën përkatëse të Kodit dhe me politikat tona.



Personi i Kontaktit:

Menaxheri juaj i linjës

Skuadra juaj lokale e Compliance



Kodi ynë i Sjelljes | Veprojmë si duhet

Çfarë do të thotë kjo përmua?

Ne presim që ju:

- Të silleni në mënyrë etike, të jeni krenarë përmë veprimet dhe vendimet tuaja
- Të pajtoheni me parimet dhe rregullat e “Kodit tonë të Sjelljes” dhe të përbushni detyrimet ligjore dhe rregullatore
- Të kuptioni udhëzuesin “The Digital Vodafone Way” dhe të zbatoni Parimet e parashikuara në këtë Kod gjatë punës suaj të përditshme
- Të shprehni mendimin tuaj në përmjet “Speak up” nëse mendoni se praktika e punës nuk është etike ose e duhur, ose bie ndesh me “Kodin tonë të Sjelljes”.

Respektimi i ligjit

Vodafone i zhvillon aktivitetet e veta në shumë shtete. “Kodi ynë i Sjelljes” nuk mund të mbulojë të gjitha ligjet dhe rregulloret në të gjitha këto shtete. Duhet që gjithnjë të jeni familjarë me ligjet dhe rregulloret përkatëse që aplikohen në vendin ku ju punoni. Nëse ekziston ndonjë diferenca ndërmjet kërkesave lokale ligjore dhe “Kodit” tonë, ndiqni standardin më të reptë.

Nëse keni ndonjë dyshim, kontaktoni menaxherin tuaj të linjës, ekipin ligjor, atë të Burimeve Njerëzore ose të Compliance.

Menaxherët e Linjës

Nëse jeni menaxher i linjës, ju keni një rol të rëndësishëm përmë të siguruar që “Kodi i Sjelljes” të kuptohet dhe zbatohet nga ekipi juaj. Në veçanti, ne presim që ju:

- Të jeni një rol model përmë “të vepruar si duhet”
- Të siguroni që pjesëtarët e ekipit tuaj ta njohin dhe kuptojnë Kodin tonë
- Të mbani përgjegjës anëtarët e ekipit tuaj që të zbatojnë Kodin tonë.



A woman with long brown hair is sitting at a wooden desk, multitasking. She is wearing a black and white polka-dot dress and a gold watch. She is holding a silver cordless phone to her ear with her left hand. Her right hand is holding a red pen and writing in a yellow notebook. On the desk in front of her is an open laptop with a red pen resting on its keyboard. There is also a white mug and some papers. In the background, there is a white shelf with books and a painting on the wall.

Speak up

› Si ta them mendimin tim?



Speak up

Nëse shikoni ose dëgjoni sjellje në vendin e punës, që mendoni se mund të shkelin “Kodin tonë të sjelljes” ose duken të jashtëligjshme ose joetike, ju lutemi raportojini. Ju duhet të raportoni çdo sjellje për të cilën dyshoni se është e jashtëligjshme ose kriminale. Kjo sjellje mund të jetë: rryshfet, mashtrim, kontroll mbi cmimet ose cënim i privatësisë së të dhënave.

Gjithashu, duhet të raportoni abuzimin e sistemeve, proceseve ose politikave tona. Këtu mund të përfshihen: shqetësimi (bullizmi) ose ngacmimi, konflikte të interesit, rreziku ndaj shëndetit dhe sigurisë së punonjësve ose publikut, abuzim i mundshëm i të drejtave të njeriut ose çështjet serioze mjedisore.

Vodafone ka një politike të mos-shpagimit kur është raportuar një shqetësim real. Ndaj jush nuk do të merret asnjë masë nëse raportoni shqetësimin tilla, edhe nëse provohet se ato nuk përbëjnë sjellje të jashtëligjshme që rezulton në shkelje të regullave.

Unë jam një kontraktor që punoj në një kontratë me Vodafone dhe kam një shqetësim për të raportuar. A mund ta përdor linjen e jashtme të raportimit “Speak up”?

Po. Linja e jashtme e raportimit “Speak Up” mund të përdoret nga punonjësit dhe kontraktorët, por edhe nga furnitorët, partnerët e biznesit, bashkëpunëtorët dhe agjentët e Vodafone.

Kam një shqetësim lidhur me veprimet e një kolegu/eje. Si duhet ta raportoj këtë?

Gjëja më e rëndësishme është që ju ta raportoni shqetësimin tuaj. Në fund të fundit, nuk ka rëndësi se çfarë mënyre zgjidhni. Nëse ndiheni më mirë të flisni me menaxherin e linjës, atëherë flisni me të. Menaxheri juaj i linjës është aty për t'ju përkrahur dhe mund t'ju ndihmojë të zgjidhni mënyrën e duhur të veprimit.

Jam i shqetësuar se kolegët e mi mund ta marrin vesh se kam ngritur një shqetësim. A do të mbahet i fshehtë?

Mbrojtja e identitetit të personave që ngrenë shqetësimë në mirëbesim është prioriteti ynë. Vodafone nuk do ta tolerojë hakmarrjen ndaj asnjë punonjësi që ngre shqetësimë reale. Atë që na thoni, ne do ta mbajmë të fshehtë dhe konfidenciale gjatë gjithë procesit të hetimit, në varësi të detyrimeve tona ligjore. Në shumicën e tregjeve, i disponueshëm është edhe raportimi anonim, i cili shërben si opsjon në rastet kur raportimi kryhet përmes linjës sonë të jashtme “Speak Up”. Megjithatë, vini re se ky lloj raportimi mund të na e kufizojë hetimin.

Çfarë do të thotë kjo përmua?

Hapi 1. Raportojeni çështjen te menaxheri juaj i linjës:

Ne e dimë se nuk është gjithnjë e lehtë të ngrini shqetësimë. Për t'a bërë më të lehtë, ne kemi një politikë të komunikimit të hapur, ndaj ju nxismë të diskutoni të gjitha çështjet ose ato potenciale me menaxherin tuaj të linjës.

Hapi 2. Raportojeni tek ekipi lokal i Burimeve Njerëzore:

Nëse nuk është e përshtatshme që ta diskutoni çështjen me menaxherin tuaj të linjës, atëherë duhet ta diskutoni me ekipin tuaj lokal të Burimeve Njerëzore.


Hapi 3. Raportojeni çështjen tuaj në konfidencialitet në linjën tonë të jashtme të raportimit “Speak Up” duke përdorur telefonin ose aplikacionin:

Ju mund të doni ta raportoni çështjen tuaj tek dikush që është nuk është i përfshirë ne situatë. Mund të ketë raste kur raportimi i një çështjeje fillimisht nuk është i përshtatshëm ose nuk duket se është i drejtë. Të gjithë ata që punojnë për ose me Vodafone, kanë akses te një mekanizëmi jashtëm raportimi, të cilën mund ta përdorin në mënyrë konfidenciale përmes telefonit ose një aplikacioni të posaçëm.

Çfarë ndodh më tej?

Hapat e mëposhtëm përcaktojnë se çfarë duhet bërë kur dikush ngrë një shqetësim:

- Kur ju ngrini një shqetësim, do të merret një vendim se cili ekip do ta ndjekë çështjen: Ekipi i Burimeve Njerëzore, i sigurisë së korporatës ose ai ligjor apo ekuivalentët e Grupit.
- Ne më pas do të kontaktojmë personin që ka ngritur shqetësimin (kjo mund të bëhet përmes linjës së jashtme të raportimit “Speak Up”, duke ofruar një kod PIN aksesi), për t'u siguruar që marrim të gjithë informacionin që na duhet dhe për të diskutuar hapat e mëtejshëm.
- Nëse vendosim të vazhdojmë me hetimin, një ekspert i kualifikuar do të hetojë, duke e informuar personin që ka ngritur çështjen gjatë gjithë procesit.
- Ne do të mbajmë dokumente transparente dhe të sakta të të gjitha publikimeve dhe veprimeve të mëpasshme.



Për më shumë informacione, vizitonit intranetin e Vodafone

Personi i Kontaktit:
Menaxheri juaj i linjës
Ekipi lokal i Burimeve Njerëzore

Sjellja individuale

- › **Mitmarria dhe pagesat e papranueshme**
- › **Konfliktet e interesit**
- › **Dhuratat dhe mikpritja**
- › **Udhëtimet dhe shpenzimet**
- › **Menaxhimi i të dhënavëve dhe dokumenteve tona**
- › **Siguria**
- › **Klasifikimi dhe mbrojtja e informacionit**
- › **Marka jonë**
- › **Të drejtat e pronësisë intelektuale (DPI)**



Mitmarrja dhe pagesat e papranueshme

Ligji e ndalon mitmarrjen në çdo lloj mjedis komercial. Ne jemi angazhuar të kundërshtojmë të gjitha format e mitmarrjes.

Mitmarrja mund të jetë në shumë forma. Ja disa shembuj:

- Pagesat lehtësuese dhe komisioni si ryshfet
- Në situata të caktuara, edhe dhënia ose pranimi i dhuratave dhe mikpritjes mund të jetë po ashtu mitmarrje.

Pagesat lehtësuese janë të jashtëligjshme. Vodafone nuk do t'i tolerojë ato përvceçe kur siguria personale e punonjësit eshtë në rrezik. Në këtë rast, çështja duhet raportuar te ekipit lokal ligjor sa më parë.

Shumë shtete e ndalojnë ofrimin ose dhënien e çdo gjëje me vlerë zyrtarëve publikë për të influencuar veprimet e tyre. Një nga mënyrat që ne sigurohem që kjo të mos ndodhë eshtë duke mos bërë asnje dhurim politik. ^①

Mënyrat lokale të punës nuk përbëjnë përashtim nga këto rregulla. Këto rregulla aplikohen jo vetëm për të gjithë punonjësit e Vodafone, por edhe për këdo të autorizuar për të vepruar në emër të kompanisë apo për ta përfaqësuar atë, si p.sh. agjentë, këshilltarë, përfaqësues ose ndërmjetës.

“Vodafone ka zero tolerancë ndaj ryshfetit: asnje punonjës i Vodafone nuk duhet të japë ose marrë ryshfet në asnje lloj forme. Ryshfeti eshtë, jo vetëm i paligjshëm, por edhe joetik.”

Parimet tona të biznesit | Sjellja individuale

Ne veprojmë me ndershëmëri, integritet dhe drejtësi në punën tonë, si në marëdhëniet e brendshme, ashtu edhe në ato të jashtme. Ne nuk tolerojmë asnje formë të mitmarrjes, përfshi ofertat e parregullta të pagesave ose dhuratat për ose nga punonjësit. Ne shbangim të gjitha kontratat që mund të çojnë, ose sugjerojnë një konflikt të interesit ndërmjet aktiviteteve personale dhe ato të biznesit. Ne as nuk japidh dhe as nuk marrim mikpritje ose dhurata që mund të duket se mbartin një detyrim. Ne zhvillojmë marrëdhënien përfituese të përbashkëta dhe përpinqemi ta promovojmë zbatimin e Parimeve tona të biznesit me partnerët tanë të biznesit dhe furnitorët.

Gjërat që duhet të bëni

- Të jeni të kujdeshshëm kur jepni ose merrni dhurata ose mikpritje, veçanërisht kur përfshihet ndonjë zyrtar publik. Për më shumë informacion, shikoni pjesën “Dhuratat dhe mikpritja” [①](#)
- Sigurohuni që të gjitha dhuratat dhe mikpritjet të lejohen nga ligji vendor
- Duhet tē dini që Vodafone mund tē jetë përgjegjës pér veprimet e palëve tē treta
- Duhet tē dini që edhe dhurimet pér bamirësi mund tē shihen si mitmarrje nëse pagesat bëhen pér tē lehtësuar një proces ose siguruar një avantazh komersial
- Nëse jeni në dilemë, pyesni skuadrën tuaj ligjor.

Mos

- Jepni ose merrni ryshfet në asnjë formë [①](#)
- Bëni pagesa lehtësuese
- Përdorni pozitën tuaj në Vodafone pér t'u përpjekur dhe ndikuar te ndonjë person tjetër (brenda ose jashtë Vodafone) që tē japë kontribute politike ose ofrojë mbështetje ndonjë partie politike.

Ekipi im dëshiron tē mbledhë para pér një organizatë bamirësie vendase. A ka ndonjë kufizim se kujt mund t'i japim dhurime?

Nuk ka kufizime pér dhënien e dhurimeve personale. Çdo dhurim në emër tē Vodafone duhet tē jepet gjithmonë përmes Fondacionit “Vodafone”.



Konfliktet e interesit

Nëse e gjeni veten në një situatë ku interesat tuaja personale dhe ato të biznesit mund të bien ndesh, ju duhet të deklaroni këto konflikte të mundshme, të merni aprovimin për to dhe t'i regjistroni. Çdo konflikt interesit duhet të shmanget/eliminohet.

Për t'ju ndihmuar të vendllohi me ndonjë konflikt të mundshëm interes, imaginoni sikur veprimet tuaja po ua shpjegoni shokëve, kolegut a koleges ose medias dhe pyesni veten nëse do të ndiheshit mirë apo jo. Menaxheri juaj i linjës do të mund t'ju ndihmojë për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë konflikt dhe nëse ky rast është aktual apo i mundshëm.

Për të shmangur ndonjë konflikt të mundshëm ose të perceptuar kur punësoni punonjës të qeverisë ose të ndonjë sektori tjetër publik, zbatohen rregulla shtesë. Për më shumë informacion, lexoni "Politikën për konfliktin e interesit".



Unë punoj me kohë të pjesshme
në biznesin e familjes time.

A duhet të flas me menaxherin tim të linjës?

Po. Edhe nëse biznesi nuk ka lidhje me Vodafone. Menaxheri juaj i linjës do t'ju ndihmojë të përcaktoni
nëse situata juaj përbën konflikt aktual ose të
mundshëm dhe do t'ju udhëzojë lidhur me hapat
që duhet të ndiqen në secilën rrethanë.

Një shok i ngushtë po aplikon për një vend pune
në Vodafone. A është në rregull kjo gjë?

Ne ju inkurajojmë ta rekomandoni Vodafone si një
vend të shkëlqyer për të punuar. Megjithatë, duhet të
siguroheni që nuk përfshiheni në procesin e rekrutimit
dhe që roli i punës në fjalë të mos raportojë tek ju.

Këtu janë disa shembuj të **konflikteve reale të interesit** të cilat duhet të shmangen ose zgjidhen menjëherë:

- Çdo aktivitet jashtë biznesit që ndikon në uljen e aftësisë tuaj për t'i kushtuar kohën dhe vëmendjen e duhur përgjegjësive tuaja brenda Vodafone
- Rekrutimi ose menaxhimi i një të afërmë ose partneri
- Rekrutimi i një individi për shkak të lidhjeve të tij të rëndësishme politike të cilat supozohet se do të gjenerojnë përfitime për Vodafone
- Një interes personal ndaj një furnitori, klienti ose konkurrenti i cili ndikon vendimet tuaja në punë
- Përdorimi i burimeve të Vodafone për aktivitete politike.

Këtu janë disa shembuj të **konflikteve të mundshme të interesit**, të cilat janë situate që ju kërkojnë të pajtoheni me mënyrën si do të siguroheni se konflikti nuk do të materializohet, të merrni aprosimin dhe ta regjistroni interesin:

- Anëtarësimi (juaj ose i një të afërmë tuaj) në bordin e një kompanie ose organizate tjeter
- Punësim tjeter
- Një marrëdhënie e ngushtë me një menaxher të lartë të një konkurrenti ose furnitori
- Të punuarit në të njëjtin departament ku punon edhe partneri ose i afërmë juaj
- Një interes financiar (juaji apo i një të afërmë tuaj) në një kompani furnitore ose klient biznesi. Nëse nuk jeni të sigurt nëse interesit juaj është financiar, këshillohuni me ekipin tuaj lokal të Burimeve Njerëzore.



Për më shumë informacione, vizitonit intranetin e Vodafone



Personi i Kontaktit:

Menaxheri juaj i linjës
Ekipi lokal i Burimeve Njerëzore

Gjërat që duhet të bëni

- Veproni në interesin më të mirë të Vodafone, duke i dalluar konfliktet e mundshme të interesit
- Diskutoni shqetësimet tuaja me menaxherin tuaj të linjës/ekipin e Burimeve Njerëzore dhe regjistroni çdo konflikt të mundshëm të interesit
- Largohuni nga fushat e biznesit ku keni ndonjë interes personal.

Çfarë të bëni nëse gjendeni në një situatë të konfliktit të mundshëm të interesit?

Hapi 1 Deklaroni konfliktin tuaj të mundshëm të interesit duke informuar menaxherin e linjës dhe partnerin tuaj të Burimeve Njerëzore.

Hapi 2 Pajtohuni me mënyrën se si do të menaxhohet situata dhe merrni miratimin nga menaxheri juaj i linjës dhe ekipi lokal i Burimeve Njerëzore.

Hapi 3 Regjistroni situatën online në regjistrin e konflikteve të interesit, në mënyrë që ju dhe kompania juaj të jeni të mbrojtur.

Dhuratat dhe mikpritja

Ne e mbështesim dhënien dhe marrjen e arsyeshme dhe proporcionale të mikpritjes në kuadër të marrëdhënieve normale të biznesit. Megjithatë, ne ndalojmë dhënien ose marrjen e dhuratave dhe mikpritjes nëse janë të tepërtë apo jo të arsyeshme. ⁽ⁱ⁾

Ne duhet të sigurohemi që të mos influenco hemi kurrë, ose të mos kërkojmë të influenco hemi me anë të dhuratave ose mikpritjes. Për shembull, ne nuk japim ose marrim dhurata ose mikpritje gjatë një procesi tenderimi ose gjatë negociatave për një kontratë të re.

Në Politikën "Anti - Bribery" të Vodafone, përcaktohen parimet që të gjithë ne duhet të ndjekim, përfshi kërkosat për aprovim dhe regjistrimin e artikujve të dhënë ose të marrë.

Gjithashtu, kemi procese të tjera aprovimi për dhënien ose marrjen e dhuratave ose mikpritjes nga zyrtarët publikë.

Gjërat që duhet të bëni

- Dhënia apo marrja e dhuratave duhet të ndodhë rrallë
- Mendoni rreth kontekstit të dhuratës ose mikpritjes dhe sigurohuni që të ketë shkaqe legitime: imaginoni se si do t'i duket dikujt jashtë Vodafone ose si do të dukej në faqen e parë të gazetës
- Nëse dhurata ose mikpritja përfshin ndonjë zyrtar publik, ju lutemi të këshilloheni me skuadrën tuaj të Compliance pasi mund t'ju nevojitet aprovim shtesë nga drejtori i Marrëdhënieve me Jashtë Grupit
- Njihni dhe kuptioni rregullat për dhuratat dhe mikpritjen për tregun tuaj
- Kërkoni miratim dhe regjistrojini dhuratat dhe mikpritjen kur kërkohet nga politika juaj.

Mos

- Jepni ose merrni dhurata ose mikpritje me vlerë të papërshtatshme
- Jepni ose pranoni dhurata ose mikpritje gjatë një procesi tenderi ose gjatë negociatave për një kontratë
- Jepni ose pranoni të holla ose mijete monetare ekivalente
- Jepni ose pranoni dhurata ose mikpritje që nuk kanë për qëllim një interes legitim biznesi
- Kërkoni dhurata ose mikpritje.



Unë jam ftuar në një darkë nga një furnitor potencial që aktualisht po ka shfaqur interes për një kontratë të re. Çfarë duhet të bëj?

Ju duhet të refuzoni. Është e papërshtatshme të shkoni për drekë/darkë ose në çfarëdolloj evenimenti tjetër mikpritjeje me një furnitor gjatë procesit të tenderimit ose dorëzimit të kërkesave për propozime.

Një furnitor më ka dërguar një dhuratë me vlerë të madhe dhe nuk dua ta fyej duke ia kthyer. Çfarë duhet të bëj?

Është e rëndësishme të njoftoni menaxherin tuaj të linjës dhe të kërkoni këshilla nga ekipi lokal i Burimeve Njerëzore dhe ai ligjor. Më e mira është që ta refuzoni me mirësjellje dhe ta ktheni dhuratën. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë sendi duhet të dhurohet për bamirësi.

Më vonë, gjatë këtij muaji, do të udhëtoj jashtë vendit dhe më duhet të marr shpejt një vizë për punë. Personi që shqyrton kërkesën time në ambasadë më ka thënë që mund ta shpejtojë procesin nëse paguaj një shumë të vogël në të holla. A është korrekte kjo?

Jo. Kjo duket si pagesë lehtësuese, e cila është formë rryshfeti dhe e paligjshme. Ju duhet ta refuzoni ofertën dhe ta raportoni këtë rast tek ekipi juaj lokal ligjor. Nëse ekziston mundësia për një shërbim zyrtar më të shpejtë—në kuadrin e një shërbimi të shpejtë të disponueshmë për publikun—atëherë mund të vazhdoni. Megjithatë, nëse nuk jeni të sigurt, gjithmonë duhet të konsultoheni më parë me ekipin tuaj ligjor.



Për më shumë informacione, vizitonit iintranetin e Vodafone



Personi i Kontaktit:

Menaxheri juaj i linjës
Ekipi juaj lokal ligjor
Ekipi i Grupit për parandalimin e rryshfetit



Udhëtimet dhe shpenzimet

Në politikën tuaj lokale për “Udhëtimet dhe shpenzimet”, përcaktohen rregullat që duhet të ndiqni. Ajo përmban të gjitha informacionet përkatëse, përfshi udhëzimet lidhur me mënyrën se si të përdorni agjencinë tonë të caktuar të udhëtimit dhe si të rezervoni në internet.

Ju lutemi të vini re se rezervimet për udhëtime dhe fjetje, të bëra nëpërmjet kanaleve të tjera, nuk do të rimbursohen.

Kur planifikoni të udhëtoni, përpinquni të gjeni ekuilibrin e duhur ndërmjet nevojave të biznesit, ndikimit në mjesid, kostos financiare dhe shëndetit dhe mirëqenies suaj.



Gjërat që duhet të bëni

- Ndiqni rregullat e politikës lokale për udhëtimet dhe shpenzimet
- Rezervoni një klasë udhëtimi dhe hotel të përshtatshëm nga lista jonë e miratuar paraprakisht
- Kini një qasje të ndërgjegjshme ndaj kostove dhe kërkonim rimbursim vetëm për shpenzimet e arsyeshme dhe të domosdoshme për qëllimet e biznesit
- Merrni parasysh ndikimin në mjesid dhe përdorni mjetet lehtësuese në internet/video/audio në vend që të udhëtoni
- Merrni miratimet e duhura për shpenzimet tuaja
- Jepni provat e duhura për kërkesën tuaj për rimbursimin e shpenzimeve.

Kostot e udhëtimit për në zyrë i kam të larta. A mund të kërkoj të më rimbursohet një pjesë?

Udhëtimi i zakonshëm për në vendin tuaj të punës nuk mund të rimbursohet. Mund të ketë përashtime për punën jashtë orarit; referojuni politikës suaj lokale për hollësi të mëtejshme.

A mund të kërkoj të më rimbursohen shpenzimet për partnerin ose bashkëshorten që udhëton me mua?

Udhëtimi për qëllime pune bashkë me partnerin ose partneren, shokun ose shoqen ose një pjesëtar të familjes nuk është shpenzim që rimbursohet nga kompania. Përashtimi i vetëm bëhet në disa raste të detyrave ndërkombëtare ku ofrojmë ndihmë me kostot e udhëtimit – aty ku është e përshtatshme, këto do të diskutohen me ju drejtëpërdrejt, përpara nisjes së detyrës suaj.

Menaxhimi i të dhënave dhe dokumenteve tona

Nëse nuk ka arsyé biznesi ose kërkesë ligjore që dokumentet të mbahen, ato duhen asgjësuar me metoda ekologjike. Mbajtja e informacioneve për një kohë më të gjatë nga sa nevojitet vetëm rrit nevojën tonë për vende magazinimi.

Gjërat që duhet të bëni

- Zbatoni procedurat përkatëse, të cilat përcaktohen në Politikën lokale për menaxhimin dhe mbajtjen e dokumenteve
- Mbajini dokumentet vetëm për aq kohë sa jua kërkon politika juaj lokale.

Mendoj se do të mbaj të gjithë dokumentet, në rast se më duhet ndonjë në të ardhmen. A është në rregull kjo gjë?

Ju duhet të zgjidhni. Disa dokumente duhen mbajtur për qëllime auditimi, për taksat ose arsyé ligjore. Për shembull, dokumentet që janë të rëndësishme për ndonjë hetim ose proces gjyqësor duhet të mbahen deri në kryerjen e plotë të hetimit ose përfundimin e procesit gjyqësor. Nga ana tjetër, ftesa për një takim që është organizuar prej kohësh, është shembull i një dokumenti që duhet të asgjësoni.



Për më shumë informacione, vizitonit intranetin e Vodafone




Personi i Kontaktit:
Menaxheri juaj i linjës
Ekipi juaj lokal ligjor



Siguria

Për ne, siguria e aseteve, njerëzve dhe të dhënave të klientëve tanë ka rëndësi kritike për të realizuar premtimin për krijimin e një të ardhme digjitale të sigurt. Secili prej nesh është përgjegjës për ruajtjen dhe sigurinë e Vodafone dhe klientëve të tij. "Kodi kibernetik" qëndron në themel të pritshmërive që kemi ndaj të gjithë punonjësve në Vodafone lidhur me sjelljen dhe punën e tyre, me qëllim ruajtjen e sigurisë sonë kibernetike.





“Secili prej nesh është përgjegjës për mbrojtjen- dhe sigurinë e Vodafone dhe klientëve të tij.”

Gjërat që duhet të bëni

- Respektoni “Kodin kibernetik” në çdo kohë
- Sigurohuni që të gjithë punonjësit dhe të ftuarit të mbajnë dhe shfaqin kartat e identifikimit Vodafone kur ndodhen në ambientet e Vodafone dhe t'i heqin kur janë në vende publike
- Shkarkoni aplikacionin “International SOS” dhe ruani numrin e ndihmës telefonike, e disponueshme 24 orë/7 ditë të javës, në rast nevoje
- Raportoni çdo cënëm të të dhënave brenda 72 orësh në adresën: csoc@vodafone.com

Mos

- Lidhuni me një rrjet falas/publik “wi-fi” nëse nuk përdorni një rrjet privat (“VPN”) të miratuar
- Ndani informacione të ndjeshma/konfidenciale me dikëqë nuk duhet t'i dijë ⁱ
- E lini kompjuterin të pakycur kur jeni larg tij
- Diskutoni ose punoni me informacione konfidenciale kur jeni në vende publike.

Për më shumë informacione, vizitonи intranetin e Vodafone
[Biblioteka e politikave të sigurisë](#)
[Portali i Sigurisë i Vodafone](#)

Personi i Kontaktit:
Ekipi lokal i Sigurisë

Klasifikimi dhe mbrojtja e informacionit

Të gjitha dokumentet, prezantimet dhe emalet janë informacione thelbësore biznesi të cilat duhet të klasifikohen në mënyrë të saktë.

C1 Publik

Informacioni mund të qarkullohet lirshëm jashtë Vodafone. Miratimi për publikimin fillestar kërkonet nga departamentet e kompanisë që janë përgjegjëse për deklaratat publike.

Shembujt përfshijnë: deklaratat për shtyp, deklaratat publike dhe materialet e marketingut.



C2 I përgjithshëm

Në këto informacione kanë akses vetëm punonjësit e Vodafone, kontraktorët e autorizuar ose palët e treta të besuara.

Shembujt përfshijnë çdo informacion tjeter që nuk klasifikohet si "C1", "C3" ose "C4".

C3 Konfidencial

Informacione që qarkullohen brenda kompanisë vetëm sipas nevojës për informim ose, për palët e treta, në bazë të një marrëveshjeje për mospërhapje informacionesh. Cënimi i sigurisë do të conte në dëmtim të reputacionit dhe dëm të konsiderueshëm finansiar.

Shembujt përfshijnë: të dhënët e klientëve dhe ato personale, marrëveshjet tregtare dhe informacioni për produktet & dizajnit teknik.



C4 Sekret

Informacione që qarkullohen vetëm tek individë të caktuar dhe që janë të koduara dhe të kontrolluara reptyesht. Cënimi i sigurisë do të shkaktonte ndikim të madh te klientët, çmimi i aksioneve ose pasoja ligjore të mëdha.

Shembujt përfshijnë: të dhënët për shkrirjet kompanive dhe blerjet e bizneseve, rastet ligjore dhe përbajtjet e komunikimeve të klientëve.



Informacione "jo-Vodafone"

Të dhëna personale që nuk i përkasin Vodafone dhe që janë të dukshme për Vodafone dhe palët e jashtme.

Nuk ka shenjim

Shënimi është shtuar automatikisht në fundin e dokumentit



Marka jonë

Ne kemi një ndër markat më të vlefshme në botë. Këtë asset duhet ta mbrojmë duke e përdorur në mënyrë të qëndrueshme. Ju mund të ndihmoni në mbrojtjen e markës Vodafone duke ndjekur udhëzimet tona për markën. Kjo do t'ju ndihmojë të siguroheni që marka jonë të jetë e mirëmenaxhuar, e mbrojtur dhe të ndërtojë besim, besnikëri dhe admirim.

Gjërat që duhet të bëni

- Siguroni përputhshmërinë me udhëzimet për markën tonë
- Raportoni çdo dyshim për keqpërdorim të markës, logove ose të drejtave të tjera të pronësisë intelektuale të Vodafone duke përfshirë mallrat imitacion.

Mos

- Lejoni asnjë palë të tretë të përdorë markën ose logon e Vodafone pa e diskutuar këtë më parë me ekipin tuaj lokal ligjor.



Të drejtat e pronësisë intelektuale (DPI)

Të drejtat tona të pronësisë intelektuale janë aset i vlefshëm, që na dallon nga konkurrentët tanë. Nëse dështojmë në mbrojtjen dhe regjistrimin e këtyre DPI-ve, ne humbasim asetet. Ne marrim patenta për të mbrojtur idetë tona, duke përfshirë përparimet e teknologjisë, produktet dhe shërbimet e reja. Secili prej nesh është përgjegjës për të siguruar që ne menaxhojmë DPI-të tona dhe parandalojmë përdorimin e paautorizuar. Është po aq e rëndësishme të respektojmë edhe DPI-të e të tjerve.

Një nivel i mëtejmë përgjegjësie që kemi futur është kuadri ligjor i saktë me partnerët dhe furnitorët tanë, që mbështet objektivat tona të biznesit dhe menaxhimin efikas të përfitimeve dhe rreziqeve.

 Për më shumë informacione, vizitonit intranetin e Vodafone

 **Personi i Kontaktit:**
Ekipi juaj lokal ligjor
Ekipi i markave tregtare
Ekipi i Privatësisë

Gjërat që duhet të bëni

- Sigurohuni që idetë tuaja novatore për produktet të jenë të mbrojtura nga patenta
- Kaloni menjëherë të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me DPI-të ekipit tuaj lokal ligjor.

Mos

- Përdorni softuer të licensuar të hapur pa verifikuar kushtet e licensës.

Nuk jam i sigurt nëse ideja që kam ka ndonjë vlerë. A mund ta diskutoj këtë me furnitorët që të marr mendimin e tyre?

Jo. Idenë tuaj duhet ta diskutoni në fillim me ekipin tuaj. Nëse doni komente të mëtejshme, jeni të lutur të kontaktoni me ekipin tuaj lokal ligjor ose ekipin e DPI-ve.

Ndonjëherë, në një tezgë të supermarket, shoh produkte që mbajnë logon “Vodafone”. Mendoj se janë false. A duhet të informoj ndonjë person?

Po. Shqetësimet tuaja duhet t'ia raportoni ekipit tuaj lokal ligjor dhe t'i dërgoni sa më shumë të dhëna ekipit të markës tregtare. Është e rëndësishme të mbrojmë markën dhe reputacionin tonë. Mund t'ju kërkojnë të blini një mostër të artikullit për të ndihmuar hetimin.

Në ekipin tim, diskutojmë për aksesorë ose shtesa të produkteve dhe shërbimeve ekzistuese, por nuk kemi gjetur asnjë vend ku t'i hedhim këto ide. A ekziston një vend i tillë?

Po. Në intranet gjendet një platformë ideimi, e cila e bën shumë të lehtë shkëmbimin e ideve, koncepteve të reja ose propozimeve.

Pajtueshmëria me ligjin

- › **Marrëveshjet e brendshme**
- › **Ligjet e Konkurrencës**
- › **Parandalimi i pastrimit të parave**
- › **Sanksionet**
- › **Kontrollet e tregtisë**



“Ne synojmë të respektojmë
të gjitha ligjet e brendshme
dhe ndërkombëtare në
fuqi dhe standartet dhe
parimet e përshtatshme.”

Marrëveshjet e brendshme

Në shumë vende, është e jashtëligjshme që njerëzit të përfitojnë nga marrëveshjet e brendshme. Kjo nënkupton përdorimin e informacioneve—të cilat nuk janë të disponueshme për të gjithë, por te të cilat ju keni akses për shkak të punës ose marrëdhënieve të biznesit—për të marrë vendime të informuara lidhur me blerjen ose shitjen e aksioneve ose letrave me vlerë.

Këto informacione mund të ndikojnë në vlerën e këtyre aksioneve ose letrave me vlerë nëse bëhet publik. Tregimi i letrave me vlerë ose manipulimi i çmimit të aksioneve bazuar mbi informacionin që mund të keni për shkak të punës që bëni në Vodafone, është i ndaluar. Këto rregulla vlejnë edhe pasi të ndaloni së punuari për Vodafone.

Në shumicën e shteteve, përdorimi i marrëveshjeve të brendshme çon në gjoba të rënda, ku pjesëmarrësit përballen ose gjobë të rëndë, me burg, ose me të dyja. Ndaj, ju lutemi, diskutoni çdo shqetësim ose pyetje që keni me ekipin e Sekretariatit të Korporatës së Grupit.

Parimi i biznesit | Pajtueshmëria me ligjin

Ne synojmë të respektojmë të gjitha ligjet e brendshme dhe ndërkombëtare në fuqi dhe standartet dhe parimet e përshtatshme.

Gjërat që duhet të bëni

- Diskutoni çdo shqetësim ose pyetje që keni me skuadrën e Sekretariatit të Korporatës së Grupit.

Mos

- Blini, shisni ose, të tregtoni letra me vlerë të Vodafone nëse keni informacion të brendshëm
- Shisni ose të tregtoni letra me vlerë të asnjë kompanie nëse keni informacion të brendshëm (i)
- U jepni informacione jepni informacione të brendshme palëve të treta. Duke vepruar kështu, jo vetëm që shkelni konfidencialitetin, por mund të kryeni edhe ndonjë shkelje.

Një shoku im do të shesë disa aksione të Vodafone pas disa ditësh. Unë e di që Vodafone do të bëjë një njoftim që do të ketë ndikim pozitiv në çmimin e aksioneve. A është në rregull që unë t'i jap ndonjë ide shokut tim se nuk duhet t'i shesëaksionet?

Jo. Ju nuk duhet të jepni kurrë informacione rrëth biznesit të Vodafone, kur këto informacione nuk janë publike. Nuk duhet as të përdorni informacionin e brendshëm për të ndikuar te vendimet e të tjera të përvetësoj.



Ligjet e Konkurrencës

Ne besojmë në konkurrencën e lirë e të drejtë. Pjesa më e madhe e tregjeve ku zhvillojmë aktivitetin tonë kanë hartuar ligje me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë e të ndershme. Këto ligje i ndalojnë marrëveshjet me konkurrentët me të cilat cënohet tregu dhe mund të zbatohen si për Vodafone, ashtu edhe për organizata të tjera. Kurrë nuk duhet të kërkon, pranoni ose diskutoni informacione konfidenciale me konkurrentët.

Praktikat antikonkurrencë mund të dëmtojnë biznesin. Kurrë nuk duhet të nxisni klientët, furnitorët ose ish-punonjësit e konkurrentëve për t'ju dhënë informacion që duhet ta mbajnë konfidenciale. 

 Për më shumë informacione, vizitonit intranetin e Vodafone

 **Personi i Kontaktit:**
Ekipi juaj lokal ligjor
Ekipi Rregullator

Gjërat që duhet të bëni

- Sigurohuni që e kuptioni mënyrën se si mund të zbatohet e drejta e konkurrencës në rolin tuaj
- Mos harroni që praktikat antikonkurrencë përfshijnë marrëveshjet joformale dhe shkëmbimin e informacioneve me konkurrentët si dhe kontratat formale
- Kuptioni që jo gjithmonë është e dukshme se cilët janë konkurrentë tanë. Edhe disa prej furnitorëve, klientëve dhe partnerëve tanë të biznesit konkurrojnë me ne. Për shembull, shumë prej shpërndarësve tanë janë konkurrentë të drejtpërdrejtë të vetë kanaleve tona të shitjes me pakicë.

Kam marrë vesh se njëri prej shpërndarësve të Vodafone ka ofruar telefona “Vodafone” me një ulje të konsiderueshme çmimi në krahasim me çmimin e rekomanduar të shitjes me pakicë. Çfarë duhet të bëj?

Asgjë. Partneri ka të drejtë të bëjë zbritje/ulje çmimi. Dërgimi i një emaili te pala juaj homologe e shpërndarësit, për t'i kërkuar që të ndalojë së uluri çmimin, mund të çojë në ruajtje të çmimit të rishitjes, çka mund të përbëjë shkelje të të drejtës së konkurrencës.

Mos

- Ndani informacione sensitive me konkurrentët (p.sh. çmimet, kostot dhe vëllimet e shitjeve)
- Bini dakord me konkurrentët për të fiksuar çmimin e produkteve ose shërbimeve, duke përfshirë uljet e çmimit, rabatet dhe komisionet
- Bini dakord të ndani llogari, rajone dhe tregje të caktuara midis nesh dhe konkurrentëve
- Caktoni – drejtpërdrejt ose tërthorazi – një çmim minimal të rishitjes.

Jam në një festë dhe dikush që punonte dikur për Vodafone, por tani për një konkurrent, thotë se kompania po lë një pjesë tregjesh enterprise për t'u përqendruar te biznesi konsumator. Cila është gjëja e duhur që duhet bërë për të siguruar që për Vodafone nuk ka rrezik nga ligjet e konkurrencës?

Ky duket qartë që është informacion tregtar dhe sensitiv në aspektin e konkurrencës. Duhet të ndërprisni bisedën dhe të siguroheni që ky informacion të mos ndahet brenda Vodafone.

Parandalimi i pastrimit të parave

Përdorimi i teknologjisë sonë për të krijuar shërbime të reja dhe novatore digitale që përmirësojnë jetën e konsumatorëve tanë qëndron në zemër të Vodafone. Shërbimet tona financiare si "M-Pesa", kanë shumë përfitime sociale dhe po përmirësojnë përfshirjen financiare në shumë prej tregjeve tona.

Është me shumë rëndësi që këto ambicie dhe përfitme të mos rezikohen nga përdorimi abuziv i këtyre shërbimeve për qëllime kriminale.


Ne kemi një qasje të fuqishme ndaj parandalimit, zbulimit dhe raportimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Ne kemi sisteme të bazuara në monitorimin e riskut, dhe kontolle të përshtatshme mbi produktet tona financiare. Të gjithë punonjësve, duke përfshirë edhe kontraktorët, u kërkohet të raportojnë çdo dyshim për pastrim parash te zyrtari lokal për raportimin e pastrimit të parave, ose te kampioni ose kampionia e "Politikës për PPP-në" të Grupit "Vodafone".

Pse duhet t'i respekojë Vodafone rregulloret për parandalimin e pastrimit të parave? Mendoja se këto rregullore vlenin për bankat.

Vodafone ofron shërbime financiare në disa tregje lokale, siç është produksi "M-Pesa", i cili na vë në fushëveprimin e rregulloreve për parandalimin e pastrimit të parave.

Unë kam parë një transaksion që nuk më duket i rregullt. Nuk jam i sigurt nëse është pastrim parash apo veprim i ligjshëm. Çfarë duhet të bëj?

Për të konfirmuar dyshimin, nuk ju duhen prova konkrete. Nëse ka arsyé për të dyshuar që transaksi mund të ketë lidhje me të ardhura nga një krim, nga ju kërkohet të bëni një raportim te zyrtari juaj lokal për raportimin e pastrimit të parave. Pas raportimit, sigurohuni që çështja të mbetet konfidenciale.



Për më shumë informacione, vizitonit intranetin e Vodafone

Personi i Kontaktit:
Ekipi juaj lokal ligjor

Sanksionet

Vodafone duhet të veprojë në përputhje me ligjet e sanksioneve në shumë vende. Këto ligje nuk e lejojnë Vodafone të hyjë në marrëveshje me njérëz, kompani, vende dhe rajone të caktuara. Ka kërkesa shtesë nëse jeni qytetar ose qytetare amerikane, përdorni dollarë amerikanë ose ndërvepron me një produkt ose shërbim amerikan, sepse legjislacioni për sanksionet i Shteteve të Bashkuara zbatohet kur përfshihen qytetarët amerikanë, produktet amerikane ose monedha e SHBA-së.

Ne kemi një "Politikë globale për sanksionet ekonomike" dhe program mbështetës për të siguruar përputhshmërinë me ligjet përkatëse.

Gjërat që duhet të bëni

- Mësoni se cilat vende konsiderohet se kanë nivel të lartë risku për sanksionet
- Jini të kujdeshshëm për rreziqet e sanksioneve kur lidhni marrëveshje në vendet me nivel të lartë risku
- Nëse keni dyshime, këshillohuni menjëherë me kampionin tuaj lokal të politikës së sanksioneve ose me ekipin tuaj ligjor.

Jam duke përzgjedhur një furnizues të ri përmes Kompanisë së Prokurimit të Vodafone (VPC—Vodafone Procurement Company). A duhet ta shqyrtoj furnizuesin duke e krahasuar me listën e sanksioneve?

Jo. Procesi qendror i rekrutimit i VPC-së përfshin shqyrtimin e furnizuesit duke e krahasuar atë me alarmet e kuqe të pajtueshmërisë, ku përfshihet edhe lista e sanksioneve. Referohujuni kampionit lokal të sanksioneve lidhur me shqyrtimin e furnizuesve të kontraktuar në nivel lokal.

Jam mbajtës i kartës së gjelbër amerikane. Aduhet të përmbush ndonjë kërkesë specifike?

Duke qenë se legjislacioni për sanksionet i SHBA-vë zbatohet për të gjithë shtetasit amerikanë, duke përfshirë edhe mbajtësit e kartës së gjelbër dhe shtetasit me dy kombësi kudo që ndodhen, programi ynë kërkon nga të gjithë shtetasit amerikanë të kryejnë trajnimin në internet për vetëdijesimin për sanksionet dhe kontrolllet tregtare dhe të konsultohen me ekipin tuaj ligjor përpëra se të hyjnë në marrëveshje në juridiksione me nivel të lartë reziku.



Kontrollet e tregtisë

Duke qenë se Vodafone është kompani ndërkombëtare, e cila eksporton mallra dhe shërbime drejt klientëve, partnerëve, furnitorëve dhe personelit të vet në gjithë botën, ne na duhet të veprojmë në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi për kontrollin e tregtisë.

Kontrollet tregtare synojnë të kontrollojnë qarkullimin nga njëri shtet në tjetrin të mallrave të caktuara, teknologjisë (qoftë në formë fizike ose elektronike), njojurive praktike dhe shërbimeve. Disa mallra të kontrolluara janë dukshëm të evidentueshme, si p.sh. armët dhe kimikatet, por mallra të tjera, si ruter të caktuar, antena, satelitë, kabllo furnizimi me energji elektrike dhe shasi rrjeti, nuk janë edhe aq të dukshme.

Kur këto mallra të kontrolluara transportohen përej kufijve kombëtarë, ato duhet të pajisen me një licencë importi ose eksporti. Kontrollet e tregtisë paraqesin rëndësi për të gjithë punonjësit e Vodafone, por në veçanti për ata që përfshihen në këto aktivitete: import, eksport ose ri-eksport i produktave (harduer ose softuer), teknologji ose shërbime (duke përfshirë lëvizjet brenda Grupit), kërkimi dhe zhvillimi.

 Për më shumë informacione, vizitoni intranetin e Vodafone

 **Personi i Kontaktit:**
Ekipi i Grupit për kontrollet e eksporteve
Kampioni lokal i kontrollit të tregtisë
Ekipi juaj lokal ligjor

 Kodi ynë i Sjelljes | Veprojmë si duhet

Ne kemi një Politikë globale për kontrollet e tregtisë dhe programe mbështetëse për të siguruar përputhshmërinë gjatë eksportimit ose ri-eksportimit të produkteve dhe teknologjisë së mundësuar nga palë të treta ose të zhvilluar brenda vendit.

Gjërat që duhet të bëni

- Plotësoni "Formularin e vlerësimit të klasifikimit tregtar" përparrë eksportimit ose ri-eksportimit të çdo produkti, teknologjje ose shërbimi të zhvilluar nga Vodafone ose një pale e tretë, për të konstatuar nëse duhet marrë licensa
- Gjithmonë veproni në përputhje me kushtet e licensës së importit/eksportit dhe kërkesat e raportimit
- Nëse keni dyshime, kontaktoni me ekipin tuaj ligjor lokal.

Mos

- Aplikoni për licescë importi ose kontrolli tregtie pa ndihmën e kampionit ose kampiones lokale të kontrollit të tregtisë.

Po dërgoj në një shtet tjetër disa pajisje të një pale të tretë. Si të sigurohem që tregtia e këtyre artikujve është e kontrolluar?

Mund të kontaktoni me prodhuesin palë e tretë për të kërkuar numrin e klasifikimit të kontrollit të eksportit (ECCN) të produktit. Kampioni juaj lokal i kontrollit të tregtisë do ta përdorë numrin ECCN për t'ju informuar nëse tregtia e pajisjeve është e kontrolluar apo jo.

Si mund të aplikoj për licensë importi ose eksporti?

Pasi të plotësoni "Formularin e vlerësimit të klasifikimit tregtar", do t'ju jepen udhëzime nga ekspertë nëse ekziston apo jo nevoja për licensë.

A photograph of a woman with blonde hair smiling at the camera. She is positioned in the center-right of the frame. In the background, two men are engaged in conversation; one man is on the left wearing glasses and a blue sweater, and another man's back is visible on the right. The background is softly blurred.

Shëndeti dhe siguria

- › **Rregullat absolute**
- › **Fushat elektromagnetike (FEM)**
- › **Droga dhe alkooli**

“Ne mbrojmë shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e klientëve, punonjësve, partnerëve dhe komuniteteve ku veprojmë.”

Shëndeti dhe siguria

Ne presim që të gjithë në Vodafone të sillen në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme gjatë gjithë kohës. Ne do të ndërhyjmë shpejt nëse ndodh të kompromentohet shëndeti ose siguria.

Vetëm nëpërmjet përgjegjësisë kolektive ne mund të sigurojmë se produktet dhe shërbimet tona janë të sigurta për t'u përdorur nga klientët tanë.



Parimi i biznesit | Shëndeti dhe siguria

Ne mbrojmë shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e klientëve, punonjësve, partnerëve dhe komuniteteve në të cilat punojmë dhe ndajmë çdo informacion për të cilin vihem i njëjshëm që tregon qartë se ndonjë prej produkteve ose shërbimeve tona cënon standarde ose udhëzimet e sigurisë të pranuara në nivel ndërkombëtar.

Gjërat që duhet të bëni

- Zbatoni "Rregullat absolute" për t'u kujdesur për veten dhe sigurinë e të tjerrëve
- Ndërhyjni shpejt nëse shikoni që dikush po sillet në mënyrë të pasigurt
- Raportoni incidentet, rreziqet e mundshme dhe incidentet potenciale, me qëllim që të ndihmojmë në nxjerrjen e mësimave dhe në parandalim
- Merrni parasysh se si vendimet dhe veprimet tuaja do të ndikojnë shëndetin dhe sigurinë si dhe të tjera
- Vlerësoni dhe njihni performancën e mirë të sigurisë.

Po udhëtoni me një koleg të ri pune; ju hipni në taksi në aeroport. Ndërkoqë që taksia niset, kolegu juaj nuk e ka vënë rripin e sigurimit, Çfarë duhet të bëni?

Kujtojini Rregullin absolut dhe pse është i rëndësishëm për sigurinë e tyre. Sigurohuni që ata ta lidhin rripin e sigurimit

Shpesh, teksa eci në zyrë, më duket se ka gjera që mund të paraqesin rrezik, nuk janë gjëra që mund të lëndojnë dikë, por që mund të shkaktojnë lëndime të lehta. Unë nuk jam i sigurt nëse kam autoritetin t'i ndaloj njerëzit dhe t'u them që ajo që po bëjnë është e rrezikshme.

Të gjithë në Vodafone kanë autoritetin të ndërhyjnë dhe të ndalojnë diçka që është e rrezikshme. Personi mund të mos e kuptojë që është e rrezikshme derisa t'ja keni vënë në dukje ju. Në përgjithësi, nëse duket e rrezikshme, atëherë ka mundësi të jetë e tillë.

Rregullat absolute



NE GJITHMONË i ngasim automjetet në mënyrë të sigurt dhe të ligjshme: ne e vendosim gjithnjë rripin e sigurisë



NE GJITHMONË i ngasim automjetet në mënyrë të sigurt dhe të ligjshme: kurrë nuk përdorim telefonin kur ngasim automjetin



NE GJITHMONË i ngasim automjetet në mënyrë të sigurt dhe të ligjshme: ne zbatojmë gjithmonë limitin e shpejtësisë



NE KURRË nuk punojmë nën ndikimin e alkoolit ose drogës



KURRË mos punoni në asnjë pajisje elektrike përvçese kur jeni të kualifikuar



KURRË mos kryeni punime në rrugë ose nëntokë nëse nuk jeni të kualifikuar për kryerjen e punimeve të tillë



Kur punoni në lartësi, GJITHMONË vishni pajisjet mbrojtëse, lidhni rripin e sigurisë dhe përdorni pajisje kundër rënies

Fushat elektromagnetike (EMF)

Për Vodafone, siguria e klientëve tanë, publikut, punonjësve dhe kontraktorëve është prioritet absolut. Ne veprojmë në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi për EMF në çdo juridikSION ku ushtrojmë aktivitetet tona dhe monitorojmë nga afër kërkimet e pavarura shkencore, të cilat shqyrtohen nga recensentë dhe janë në standardin më të lartë.


Ne e kuptojmë që disa njerëz vazhdojnë të janë të shqetësuar lidhur me teknologjinë telefonike dhe shëndetin. Ne vazhdojmë të angazhohemi për të ofruar informacione dhe për t'iu përgjigjur në mënyrë transparente shqetësimeve të publikut lidhur me telefonat celularë, antenat dhe shëndetin.

Teknologjia jonë e telekonomikacionit vepron plotësisht brenda limiteve të sigurisë, të caktuara sipas udhëzuesve ndërkombetarë. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) vazhdon të ketë të njëjtin mendim: nuk ka prova që do t'i bindin ekspertët që kjo teknologji paraqet ndonjë rrezik për shëndetin e njeriut.

 Për më shumë informacione, vizitonit intranetin e Vodafone

Gjërat që duhet të bëni

- Hidhini një sy trajnimit prezantues për mënyrën e funksionimit të telefonave celularë. Në të jepen informacione bazë të cilat mund t'i ndani me miqtë dhe pjesëtarët e familjes lidhur me telefonat celularë, antenat dhe shëndetin
- Vizitonit seksionin e telefonave celularë, antenave dhe shëndetit në faqen tonë të internetit për të lexuar lidhur me shkencën, teknologjinë dhe hulumtimet më të fundit
- Vizitonit “Raportin e qëndrueshmërisë” të Vodafone për më shumë informacione. Report for more information.



Droga dhe alkooli

Çdo përdorim, shitje ose shpërndarje e substancave të jashtëligjshme do të trajtohet me seriozitet të jashtëzakonshëm. Ju lutemi t'i mbështesni kolegët duke raportuar çdo shkelje të këtij kodi tek ekipi juaj lokal i Burimeve Njerëzore. Ne do t'ju ofrojmë mbështetje atyre që janë prekur nga problemet me alkoolin ose drogën.

Gjërat që duhet të bëni

- Raportoni tek ekipi juaj lokal i Burimeve Njerëzore çdo shqetësim që keni lidhur me përdorimin e alkoolit ose drogës nga ndonjë koleg/e
- Kur udhëtoni, njihuni me ligjet, kulturat dhe zakonet vendase.

Mos

- Punoni nën ndikimin e substancave të jashtëligjshme ose alkoolit.

Zakonisht, kur vjen në punë, kolegu im duket sikur është nën ndikimin e alkoolit. E di që po kalon vështirësi në shtëpi. Çfarë duhet të bëj?

Është e rëndësishme që këtë çështje ta diskutoni me menaxherin tuaj të linjës. Përdorimi i alkoolit ka gjasa të ndikojë në mirëqenien e tij dhe cilësinë e punës që bën. Mund të ndodhëqë kolegut t'i duhet ndihmë dhe mbështetje për të përballuar vështirësitë që ka.

“Ne nuk tolerojmë askënd të jetë nën ndikimin e alkoolit ose substancave të jashtëligjshme në vendin e punës.”



 Për më shumë informacione, vizitonи intranetin e Vodafone

 **Personi i Kontaktit:**
Ekipi lokal i shëndetit dhe sigurisë
Menaxheri juaj i linjës



“Ne u ofrojmë aksionerëve tanë kthimin më të mirë të mundshëm në planin afatgjatë.”

Integriteti finansiar

- › **Angazhimi në kontrata dhe shpenzime**
- › **Zbatojmë një rrjet furnizimi të përgjegjshëm**

Integriteti financiar

Ju duhet të shpenzoni paratë e kompanisë ku ka një nevojë legjitime biznesi dhe atje ku kostoja ja vlen përfitimin. Ju duhet të dini limitet lokale të shpenzimeve dhe të njihni politikat financiare të cilat zbatohen direkt për rolin tuaj.

Menaxherët tanë kanë detyrën shtesë për t'u siguruar që ekipejt e tyre i menaxhojnë mirë buxhetet dhe bëjnë kujdes me shpenzimin e parave të kompanisë.

Kur vlerësoni vlerë për para, është e rëndësishme të merren parasysh: cilësia, shërbimi, besueshmëria, qëndrueshmëria, pajtueshmëria me Kodin tonë të Blerjes Etike dhe të gjitha kushtet e përgjithshme.

Gjërat që duhet të bëni

- Kuptoni dhe zbatoni politikat për financat dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me rolin tuaj
- Përpinquni të gjeni vlerën më të mirë kur shpenzoni paratë e kompanisë
- Kuptoni kur mund dhe nuk mund të angazhoni fondet e Vodafone
- Blini të mira apo shërbime vetëm nëpërmjet furnitorëve të regjistruar.

Mendoj se kolegu im po kërkon rregullisht t'i rimbursohen fatura taksie për punën jashtë orarit, por në fakt kthehet në shtëpi duke përdorur transportin publik. Çfarë duhet të bëj?

Duhet që fillimisht të flisni me menaxherin tuaj të linjës. Përndryshe përdorni kanalet e tjera të platformës "Speak Up", nëse mendoni se kjo është më e përshtatshme.



Parimi i biznesit | Integriteti financiar

Ne u ofrojmë aksionerëve tanë kthimin më të mirë të mundshëm në planin afatgjatë. Ne i mbështesim vendimet tona për investime, blerjet dhe marrëdhëniet e biznesit në kritere ekonomike, por marrim parasysh edhe faktorët socialë dhe mjedisorë.

Angazhimi në kontrata dhe shpenzime


Ju nuk duhet ta angazhoni Vodafone në një kontratë ose të bëni shpenzime pa autorizimin e duhur paraprak.

Vodafone i nevojiten kontrata ligjore, me kushte të përgjithshme të rëna dakord përpara se të angazhojë burimet e veta. Pa këto marrëveshje, Vodafone është i eksposuar ndaj rreziqeve financiare, komerciale, tatimore dhe ligjore.

Në “Delegimin e Autoritetit” tregohet se çfarë niveli autoriteti ju nevojitet përpara se të angazhoni Vodafone në një kontratë ose në shpenzime. Pritet që të gjithë të kuptojnë se si zbatohen në punën e tyre regullat e “Delegimit të Autoritetit”.

Gjërat që duhet të bëni


- Lexoni “Politikën për delegimin e autoritetit” dhe kuptoni se si zbatohet ajo për rolin tuaj
- Sigurohuni që jeni të autorizuar të angazhoni Vodafone në një kontratë ose pagesë
- Kërkonit këshilla ligjore ose këshilla të tjera përkatëse kur është e përshtatshme
- Rishikoni me kujdes të gjitha kontratat që t’i kuptoni kushtet e tyre dhe që marrëveshja të jetë në interesin më të mirë të Vodafone.



Zbatojmë një rrjet furnizimi të përgjegjshëm

Ne e mbështesim të gjithë procesin tonë të prokurimit në Kodin tonë të Blerjes Etike. Këtë e bëjmë për të menaxhuar me përgjegjësi ndikimin e gjërë që ka biznesi ynë te komunitetet, shoqëria dhe mjedisi.

Ne po ashtu, presim që edhe furnitorët dhe kontraktorët tanë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme. Ne punojmë nga afér me ta për t'u siguruar që ata ndjekin kërkosat tona gjatë punës së tyre dhe zinxhirëve të furnizimit.



Unë kam prokurën ligjore të nënshkruaj një kontratë në tregun tim vendas, e cila është më e lartë se masa që më është përcaktuar në Delegimin e Autoritetit. A mund ta nënshkruaj kontratën meqenëse e kam prokurën ligjore, edhe pse nuk përputhet me Delegimin e Autoritetit?

Jo. Ju duhet të zbatoni si Delegimin e Autoritetit ashtu edhe prokurën. Më e mira është që të dyja të janë në përputhje.

Kam një furnitor që dyshoj se ka shkelur Kodin e Blerjes Etike. Çfarë duhet të bëj?

Këtë duhet t'ia raportoni menjëherë ekipit lokal të zinxhirit të furnizimit. Përndryshe, duhet të ndiqni procesin "Speak Up" për ta përshkallëzuar shqetësimin.

Ku do t'i gjej detajet për limitet e mia në Delegimin e Autoritetit?

"Politikën për delegimin e autoritetit" do ta gjeni në portalin e politikave globale, të cilin mund ta viziton duke përdorur intranetin tonë në Vodafone.

Për më shumë informacione, vizitonи intranetin e Vodafone

Personi i Kontaktit:
Menaxheri juaj i linjës
Ekipi juaj lokal ligjor
Ekipi lokal i rjetit të furnitorëve



Politika dhe komunikimet publike

- › Të flasësh në emër të Vodafone
- › Përdorimi i medias sociale

“Ne duam t’i fuqizojmë të gjithë punonjësit tanë, me qëllim që të jenë ambasadorë të mirë për markën tonë.”

Të flasësh në emër të Vodafone

Ne duhet t'ua komunikojmë informacionet përkatëse ekipave tona shpejt dhe qartë. Komunikimi i brendshëm duhet të jetë gjithmonë profesional, madje edhe kur është joformal.

Askush nuk duhet të bëjë komente në emër të Vodafone, përveç nëse ka marrë miratim paraprak, në përputhje me "Politikën për komunikimet e jashtme dhe komunikimet me investitorët".

Duhet të jemi gjithmonë të vetëdijshëm se të gjithë jemi përfaqësues të Vodafone dhe se çdo gjë që bëjmë dhe themi në publik përfaqëson kompaninë.

Parimi i biznesit | Politika dhe komunikimet publike

Ne komunikojmë haptas dhe në mënyrë transparente me të gjitha palët tona të interesit, brenda kufijve të konfidencialitetit tregtar. Ne mbrojmë informacionet konfidenciale që të mos shfaqen aty ku nuk duhet, ndërkohë që çdo komunikim i autorizuar i informacioneve konfidenciale duhet të kufizohet tek individët të cilëve u duhen këto informacione për të kryer punën e tyre.



Përdorimi i medias sociale

Ne duam t'i fuqizojmë të gjithë punonjësit tanë, me qëllim që të jenë ambasadorë të mirë për markën tonë. Megjithatë, nuk duam të thoni diçka që mund të ketë pasoja të padëshiruara.



“Jepni informacione të qarta dhe të sinqerta në çdo kohë, duke përdorur një gjuhë që kuptohet lehtë.”

Gjërat që duhet të bëni

- Sigurohuni që komunikimet tuaja të brendshme e të jashtme të janë profesionale, brenda afateve dhe, aty ku është e nevojshme, të miratuara
- Veproni në mënyrë profesionale kur përfaqësoni Vodafone, sidomos kur mbani veshur uniformën e Vodafone, kur përdorni ndonjë prej automjeteve tona ose kur merrni pjesë në evenimente në emrin tonë
- Informacionet konfidenciale mbajini konfidenciale.

Mos

- Bëni deklarata që do të mund të kenë ndikim negativ në reputacionin ose markën Vodafone
- Bëni komente personale të cilat mund të interpretohen, qoftë edhe gabimisht, si komente ose mbështetje nga Vodafone
- Nxirri informacione financiare ose informacione lidhur me produktet ose shërbimet e reja pa marrë miratim: rrjedhja e mesazheve dhe mesazhet e pasakta ose çorientuese mund të cënojnë seriozisht suksesin e një produkti ose shërbimi.

A më lejohet të shkruaj në profilin tim në rrjetet sociale se ku puno?

Po. Në pjesën “About” (rreth) ose “Bio” mund të shkruani se jeni punonjës ose punonjëse e Vodafone. Jini të qartë lidhur me atë se cilën pjesë të organizatës përfaqësoni dhe se çfarë përfshijnë përgjegjësitë tuaja. Mund të shënoni edhe një link të faqes lokale të Vodafone në internet.

Ka shumë udhëzues që duhet të ndjekim kur përdorim rrjetet sociale. A mund t'i përmblidhn?

Udhëzimet e përgjithshme janë këto: “Jini vetvetja”, “Përdorni arsyen e shëndoshë” dhe “Respektoni ligjin”.

Për më shumë informacione, vizitonit intranetin e Vodafone

Personi i Kontaktit:
Ekipi lokal i Komunikimit të Brendshëm
Ekipi lokal Punëve të Jashtme

Privatësia

- › Angazhimi ynë për privatësinë
- › Parimet e privatësisë
- › Si t'i zbatoni “Parimet tonë të privatësisë”

“Ne e vlerësojmë besimin që na japin klientët dhe i ruajmë informacionet që na jepen.”

Angazhimi ynë për privatësinë

Ne e vlerësojmë privatësinë për shkak të vlerës që ajo paraqet për individët. Kjo shkon përtej respektimit të ligjit: bëhet fjalë për krijimin e një kulture ku respektohet privatësia dhe përligjet besimi që të tjerët na jepin.

Vodafone është i angazhuar të përpunojë të dhënat personale në mënyrë të ndershme, etike, me integritet, dhe gjithmonë në përputhje me ligjet në fuqi dhe vlerat tonë, çka përbën arsyen pse iu përmbahemi "Parimeve të privatësisë" kur përpunojmë të dhënat personale.

Parimi i biznesit | Privatësia

Ne e vlerësojmë besimin që na jepin klientët dhe i ruajmë informacionet që na jepen.



Gjërat që duhet të bëni

- Kuptoni se si zbatohen "Parimet e privatësisë" në rolin tuaj
- Sigurohuni që, në vendimarrjen tuaj të përditshme, gjithmonë të mbani parasysh privatësinë
- Njihuni me proceset e privatësisë të cilat zbatohen për rolin tuaj, për shembull, mbrojtja e integruar e privatësisë gjatë gjithë procesit.

Parimet e privatësisë

Përgjegjshmëria

Ne jemi përgjegjës për zbatimin e duhur të këtyre parimeve në të gjithë familjen tonë të korporatës, duke përfshirë edhe punën tonë me partnerët dhe furnitorët tanë.

Ligjet dhe Standarde

Ne veprojmë në përputhje me ligjet e privatësisë dhe punojmë me qeveritë, entet rregullatore, politikëbërësit dhe formuluesit e opinionit për lige dhe standarde më të mira e më kuptimplota.

Sinqeriteti dhe ndershmëria

Ne komunikojmë qartë lidhur me veprimet që ndërmarrim, të cilat ndikojnë mbi privatësinë.

Zgjedhja dhe aksesi

Ne u japim njerëzve mundësinë të bëjnë zgjedhje të thjeshta dhe kuptimplota lidhur me privatësinë e tyre dhe u mundësojmë – aty ku është e përshtatshme – të kenë akses të dhënave të tyre personale, t'i përditësojnë ose fshijnë ato.

Privatësia në fazën e dizajnit

Respektimi i privatësisë është element kryq në projektim, zhvillim dhe realizim të produkteve dhe shërbimeve tona.

Menaxhimi i përgjegjshëm i të dhënave dhe shpalosja e kufizuar e tyre

Ne zbatojmë praktika të përshtatshme të menaxhimit të të dhënave për të rregulluar përpunimin e të dhënave personale. Ne e kufizojmë shpalosjen e të dhënave personale ndaj partnerëve tanë brenda asaj që pëershruhet në njoftimet tona të privatësisë ose brenda limiteve të autorizuara nga klientët tanë.

Masat mbrojtëse të sigurisë

Ne zbatojmë masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat personale kundër aksosit, përdorimit, modifikimit të paautorizuar ose humbjes.

Drejtpeshimi

Kur na duhet të drejtpeshojmë të drejtën për privatësi ndaj detyrimeve të tjera të nevojshme në një shoqëri të lirë e të sigurt, ne punojmë me synim minimizimin e ndikimeve mbi privatësinë.



Si t'i zbatoni “Parimet tona të privatësisë”

Oficerët tuaj të privatësisë mund t'ju ndihmojnë të kuptioni si t'i zbatoni “Parimet tona të privatësisë”. Ata mund të shpjegojnë:

- Çfarë nënkuftojnë “Parimet e privatësisë” për ju dhe ekipin tuaj
- Proseset dhe udhëzime të veçanta që duhet të ndiqni
- Si të merrni trajnim dhe ku të gjeni materiale të tjera mbështetëse.

Ju mund të bëheni avokat ose avokate e privatësisë, duke iu bashkuar “Komunititetit tonë të privatësisë” në intranetin e Vodafone.

Mua më kanë kontaktuar organet ligjzbatuese në vendin tim me një kërkesë për akses në të dhënat personale. Çfarë të bëj?

Ndonëse mund të na kërkohet nga ligji t'i përgjigjemi një kërkesë për informacion të dërguar nga qeveria ose një autoritet ligjzbatues, ka edhe kritere të tjera që duhen marrë parasysh. Sigurohuni që të dini drejtpeshimin midis detyrimeve tonë ligjore për t'iu përgjigjur dhe mbështetur zbatimin e ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut të klientëve tanë dhe një procesi të përshtatshëm. Për më shumë informacione, shihni “Politikën tonë për privatësinë dhe zbatimin e ligjit”.

Po zhvilloj një aplikacion për Vodafone, i cili do të përdorë shumë informacione personale. Si të sigurohem që privatësia mbrohet - a mund të shtoj thjesht një politikë privatësie në aplikacion?

Jo. Angazhimi ynë për mbrojtje të integruar të privatësisë gjatë gjithë procesit nënkufton që ne sigurohemi që privatësia të jetë pjesë e integruar e aplikacioneve dhe shërbimeve tonë dhe jo thjesht diçka që e shtojmë më pas. Për më shumë informacione, shihni udhëzuesin tonë për aplikacionet celulare në faqen “Privatësia” ose kontaktoni me oficerin tuaj lokal të privatësisë.

Po punoj në një projekt që përfshin përdorimin e informacioneve të klientëve, të cilat nuk mbulohen me ligj. A duhet të vazhdoj gjithsesi të mendoj për privatësinë?

Po. Angazhimi ynë për Privatësinë është të respektojmë privatësinë e klientëve. Pavarësisht nëse ka ose jo kërkesë ligjore, çdo gjë që bëjmë duhet të jetë në përputhje me “Parimet tona të privatësisë”.

 Për më shumë informacione, vizitonit intranetin e Vodafone

 **Personi i Kontaktit:**
Oficeri lokal i privatësisë

Punonjësit

- › Diversiteti dhe përfshirja
- › Parandalimi i ngacmimit dhe shqetësimeve

“Ne synojmë të krijojmë një mjedis përfshirës ku të gjithë të ndihen të respektuar dhe vlerësuar dhe të ndiejnë se janë vërtet pjesë e tij.”



Diversiteti dhe përfshirja

Ne ndjekim barazinë e mundësive dhe përfshirjen e të gjithë punonjësve përmes politikave dhe praktikave tona të punësimit.

Ne njohim dhe manifestojmë rëndësinë e diversitetit në vendin e punës, ndaj jemi të shumëllojshëm po aq sa klientët tanë të cilëve iu shërbejmë. Ne nuk do të tolerojmë asnjë formë diskriminimi, sidomos në lidhje me (por duke mos u kufizuar vetëm në këto) moshën, gjininë, aftësitet ndryshe, prirjet seksuale, prejardhjen ose besimin. Ne mbështhesim marrëdhëniet me dhe ndërmjet punonjësve në respektin për individët dhe të drejtat e tyre të njeriut. Ne nuk tolerojmë asnjë formë punësimi të fëmijëve. ⓘ

Ne të gjithë duhet ta kundërshtojmë sjelljen diskriminuese kur e vërejmë. Ne duam që të gjithë të ndjejnë se mund të ngrenë çfarëdolloj shqetësimi. Së pari, ju lutemi flisni me individët në fjalë përpara se të konsultoheni me ekipin tuaj lokal të Burimeve Njerëzore ose të kaloni nëpërmjet procesit "Speak Up".

Gjërat që duhet të bëni

- Veproni me drejtësi dhe tregoni respekt ndaj të tjerëve në të gjitha marrëdhëniet
- Sfidojeni sjelljen diskriminuese
- Ngrini çdo shqetësim përmes ekipit tuaj lokal të Burimeve Njerëzore ose përmes procesit "Speak Up"
- Mbështhesni vendimin tuaj për punësim thjesht mbi merita.

Çfarë të bëj nëse dëgjoj ndonjë koment negativ për orientimin seksual të dikujt gjatë një mbledhjeje ose takimi informal me kolegë pune, p.sh. te makineria e kafes ose salloni i pushimit?

Kjo lloj sjelljeje është e papranueshme dhe ju duhet ta kundërshtonitë nese mendoni se keni mundësi. Flisni me menaxherin tuaj të linjës ose menaxherin lokal të Burimeve Njerëzore. Nëse nuk ndiheni komod të diskutoni me ta, atëherë përdorni linjën telefonike të raportimit "Speak Up".

Parimi i biznesit | Punonjësit

Marrëdhëniet me punonjësit dhe midis tyre i mbështesim në respektin për individët dhe të drejtat e tyre të njeriut. Ne nuk e tolerojmë punësimin e fëmijëve. Ne nuk pranojmë asnjë formë diskriminimi, ngacmimi ose shqetësimi (bullizmi). Ne synojmë barazinë e mundësive dhe përfshirjen e të gjithë punonjësve përmes politikave dhe praktikave tona të punësimit.

A do të thotë që nëse jam person i komunitetit “LGBT+” nuk mund të shkoj kurrë të punoj në një shtet ku është e jashtëligjshme të jesh person “LGBT+”?

Shumë kolegë që i përkasin komunitetit “LBGT+” udhëtojnë ose jetojnë në shtete ku është e jashtëligjshme të jesh person “LGBT+”. Në të dy rastet, ata kanë mbështetjen e plotë të Vodafone. Përpara se të udhëtoni, mund të flisni me ekipin e sigurisë, i cili do të mund t’ju informojë lidhur me legjislacionin lokal, kulturën dhe nivelet e pranueshmërisë së personave “LBGT+”. Përndryshe, mund t’i dërgoni një email në linjën e tij konfidenciale në adresën: travelsecurity@vodafone.com.

Ekipl lokal i sigurisë ka një gamë materialeash të disponueshme lidhur me këtë çështje. Do t’ju jepet mbështetje e mëtejshme në internet dhe në telefon nga ofruesi ynë i shërbimit të sigurisë. Kjo duhet t’ju ndihmojë të vendosni nëse dëshironi të udhëtoni dhe, nëse po, në çfarë mase dëshironi të tregoni për jetën tuaj personale kur të jeni në takime biznesi ose kur shoqëroheni në shtetin në fjalë. Cilido qoftë vendimi juaj, do të keni mbështetjen e Vodafone.



Parandalimi i ngacmimit dhe shqetësimeve

Vodafone nuk do të tolerojë sjelljet e papërshtatshme, duke përfshirë ngacmimin, shqetësimin ose abuzimin me autoritetin. [\(i\)](#)

Ngacmimi përfshin çdo sjellje të papërshtatshme ku bëjnë pjesë: fjalët, gjestet ose veprimet që mund t'i shkaktojnë fyerje ose poshtërim një personi tjetër. Këtu bën pjesë edhe ngacmimi seksual. Ngacmimi mund të ndodhë midis anëtarëve të të njëjtës gjini ose gjinive të kundërtë, jashtë vendit të punës dhe/ose jashtë orarit të punës dhe mund të jetë incident që ndodh një herë ose që përsëritet.

Ne mund të marrim masa disiplinore dhe ligjore kundër personave të cilët kryejnë ngacmime, shqetësimë (bullizëm) ose abuzojnë me autoritetin e tyre. Ne e trajtojmë njeri-tjetrin me respekt dhe kundërshtojmë çdo sjellje të padrejtë. Të gjithë jemi përgjegjës për të siguruar që kjo të mos ndodhë në Vodafone.

Ne ofrojmë më shumë mbështetje për viktimat e dhunës në familje dhe abuzimit. Për më shumë informacione, shihni politikën tuaj lokale të Burimeve Njerëzore. Autorët e dhunës në familje, të cilët përdorin pronën dhe/ose shërbimet tonë, për të kryer ngacmime ose shqetësimë, do t'u nënshtrohen masave disiplinore.

Gjërat që duhet të bëni

- Ndërtoni besim tek ekipet tuaja duke i trajtuar të gjithë me respekt
- Sigurohuni që të gjitha komunikimet tuaja të janë në përputhje me këtë kod, pavarësisht se sa jozyrtar jeni
- Ngrini zërin nëse mendoni se ju ose një koleg apo kolege po ngacmohet ose shqetësohet.

Mos

- Jini nënçmues ose abuziv ndaj kolegëve tuaj ose në lidhje me ta



Udhëzimet janë të disponueshme në politikat tuaja lokale të Burimeve Njerëzore



Personi i Kontaktit:

Ekipi lokal i Burimeve Njerëzore

A përfshin ngacmimi seksual patjetër kontaktet fizike ose prekjet e padëshiruara?

Jo. Ngacmimi seksual mund të jetë verbal ose joverbal. Fjalët ose gjestet mund të janë po aq ofenduese sa veprimet ose kontakti fizik. Shakatë, tregimet dhe komentet e papërshtatshme mund të janë seksualisht ngacmuese nëse i shkaktojnë ofendim ose poshtërim individit ose të tjera.

“Synimi ynë është të krijojmë një ambient përfshirës ku të gjithë të ndihen të respektuar, të vlerësuar dhe të bindur se janë pjesë e qenësishme e Vodafone.”

A close-up photograph of a woman with a warm smile, her hands gently resting on her cheeks. She is wearing a red headscarf and a blue patterned scarf. The background is blurred with warm, bokeh lights.

Komunitetet dhe shoqëria

› Komunitetet lokale

“Ne do të angazhohemi me komunitetet tona lokale për të na ndihmuar të kuptojmë dhe t'i përgjigjemi çdo shqetësimi që ata kanë.”

Komunitetet lokale

Duke qenë të hapur dhe të sinqertë, duke respektuar kulturat dhe traditat, ne synojmë të fitojmë besimin dhe mbështetjen e komuniteteve tona lokale.

Ne i dëgjojmë gjithmonë shqetësimet që kanë komunitetet lokale, për shembull lidhur me shpërndarjen e rrjetit, dhe përpinqemi t'iu përgjigjemi pyetjeve kur këto ngrihen. Ne do të jemi gjithëpërfshirës dhe do të bëjmë më të mirën për tu siguruar që të gjithë dëgjojen.

Parimi i biznesit | Komunitetet dhe shoqëria

Ne synojmë të ofrojmë produkte dhe shërbime të cilat mund të transformojnë jetën e njerëzve dhe të kontribuojnë për një jetesë më të qëndrueshme duke fuqizuar individët, duke kontribuar më gjerë në qëllimet e zhvillimit dhe duke reduktuar ndikimet në mjedis.

Për të arritur këtë, ne duhet të veprojmë me përgjegjësi kurdo që ne punojmë, me qëllim që të ruajmë besimin e shoqërisë.

Unë mendoja se të drejtat e njeriut janë përgjegjësi e qeverisë? Përse duhet të shqetësohem unë për to? [①](#)

Ndonëse është detyrë e qeverive të mbrojnë të drejtat e njeriut për shtetasit e tyre, bizneset, ku bën pjesë edhe Vodafone, janë përgjegjëse për respektimin e të drejtave të njeriut dhe për të siguruar që ne të mos i shkelim këto të drejta kudo që ne operojmë.

Gjërat që duhet të bëni

- Jini të ndjeshëm ndaj nevojave të komuniteti lokal: dëgjoni dhe reagoni ndaj shqetësimeve të njerëzve lidhur me punën e Vodafone
- Merrni pjesë në komuniteten tuaj lokal nëpërmjet Fondacionit "Vodafone".



Për më shumë informacione, vizitonit intranetin e Vodafone

Personi i Kontaktit:
Vodafone Sustainable Business

“Ne jemi të angazhuar të mbrojmë mjedisin. Aty ku është e mundur, do të ulim përdorimin tonë të burimeve dhe emetimet e dëmshme për të cilat jemi përgjegjës për shkak të punës sonë.”

Mjedisi



Mjedisi

Ne jemi të angazhuar të mbrojmë mjedisin. Aty ku është e mundur, do të ulim përdorimin tonë të burimeve dhe ulim emetimet e dëmshme për të cilat jemi përgjegjës. Ne investojmë në masa me efikasitet energetik me qëllim zbutjen e efekteve të ndryshimit klimatik dhe zvogëlimin, ripërdorimin dhe riciklimin e pajisjeve të telekomunikacionit me synim uljen e sasisë së mbetjeve përmes planifikimit të kujdesshëm, projektimit, instalimit, mirëmbajtjes dhe nxjerrjes jashtë përdorimi.

Të gjitha mbetjet që nuk mund të shmanget me anë të fazës së projektimit, duhet të rishiten, ripërdoren ose riciklohen kur është e mundur. Kur është e nevojshme të hidhen, mbetjet duhet të ruhen ashtu si duhet dhe të trajtohen nga kontraktorë me licensat përkatëse, duke ofruar siguri deri në përpunimin e fundit.

Ne veprojmë në përputhje me legjisacionin dhe standartet përkatëse kombëtare dhe ndërkontinentale dhe publikojmë politika globale. Në shtetet ku legjisacioni për mjedisin nuk ekziston ose nuk zbatohet, ne do të sigurohem që të ndjekim praktika të përgjegjshme për menaxhimin e ndikimit në mjedis.

Ne punojmë me klientë, furnitorë dhe kontraktorë për të zhvilluar produkte dhe shërbime për të minimizuar ndikimin në mjedis. Ne do të ruajmë besimin e palëve të interesuara duke qenë të hapur dhe të përgjegjshëm ndaj shqetësimeve të konsumatorëve, enteve rregullatore dhe komuniteteve lokale ku ushtrojmë aktivitetet tona.



A ka ndonjë politikë globale për mjedisin?

Jo. Politikat për mjedisin ekzistojnë në secilin treg lokal.

Ku mund të gjej më shumë informacione lidhur me performancën tonë mjedisore?

Për më shumë informacion, shihni reportin vjetor për biznesin e qëndrueshëm dhe faqen për “Biznesin e qëndrueshëm”.

A keni ndonjë synim global mjedisor?

Po. Shihni faqen “Biznesi i qëndrueshëm” për t’u informuar për synimet tona aktuale mjedisore.

Gjërat që duhet të bëni

- Njihuni me ligjet, rregulloret dhe politikat përkatëse për mjedisin në tregun lokal
- Kërkonit t'i përdorni burimet tuaja me maturi, me qëllim që aty ku është e mundur, të zvogëloni mbetjet, sipas hierarkisë së mbetjeve (zvogëlim, ripërdorim, riciklim)
- Kurdo ku është e mundur, përdorni vendet lokale të riciklimit për letrën, pajisjet, bateritë, etj.
- Ecni, ngisni bicikletën ose përdorni transportin publik kur është e mundur. Merrni parasysh përdorimin e përbashkët të një automjeti me një koleg, nëse keni nevojë për një automjet
- Shmangni udhëtimet e panevojshme për të zvogëluar emetimet e karbonit: përdorni telefonatat e konferencave ose videokonferencat kur është e mundur
- Gjithnjë mendoni për mjedisin kur merrni vendime për të blerë: a është i domosdoshëm ky produkt? A ka ndonjë alternativë tjeter që e dëmton më pak mjedisin ose që është më efikase?
- Merrni parasysh gjithë ciklin e jetës së produktit në mjedis, duke përfshirë mirëmbajtjen dhe riciklimin dhe jo vetëm kostot e blerjes.



Për më shumë informacione, vizitonit intranetin e Vodafone



Personi i Kontaktit:
Ekipi lokal i punëve të jashtme

Përkuftizime



Përkuftizime

Çfarë janë ‘pagesat lehtësuese’ dhe ‘rryshfeti si komision’?

Fq. 12

Pagesa lehtësuese është zakonisht një pagesë jozyrtare në të holla që bëhet për të shpejtuar veprimet rutinë të qeverisë, për shembull, t'i paguash një zyrtari 10 dollarë për të shpejtuar një aplikim përvizë. “Rryshfeti si komision” është pagesë që i bëhet një individi në këmbim të një referimi, transaksiioni ose kontrate me një palë tjetër.

Çfarë është rryshfeti?

Fq. 13

Rryshfeti përfshin dhënien ose marrjen e të hollave, ose çdo gjëje tjetër me vlerë, për të bërë dikë të veprojë “në mënyrë të papërshtatshme” (zakonisht kjo rezulton në përfitim personal të padrejtë). Nuk është e nevojshme të këmbehet diçka me vlerë: mjafton thjesht oferta ose premtimi për ta shkelur ligjin.

Çfarë është “zyrtari publik”?

Fq. 13

Çdo zyrtar (i zgjedhur ose i emëruar) ose punonjës i një departamenti qeveritar, i cili ka pozicion legjislativ, gjyqësor ose administrativ të çfarëdo lloji, qoftë edhe përkohësisht. Këtu përfshihen: pjesëtarët e familjes mbretërore; çdo person që kryen funksione publike në cilëndo degë të pushtetit qendror, lokal ose në bashki/komunë/rajon; ose çdo person që ushtron një funksion publik për cilëndo agjenci ose ndërmarrje publike, ose institucion privat të kontrolluar nga shteti, siç janë punonjësit e ndërmarrjeve shtetërore ose që kontrollohen nga shteti, ose punonjësit që punojnë në një media shtetërore; anëtarët ose partitë politike ose kandidatët për post politik. Këtu përfshihen edhe zyrtarët ose agjentët e një organizate publike ndërkombëtare, siç është OKB-ja ose Banka Botërore.

Çfarë do të thotë “e arsyeshme dhe proporcionale”?

Fq. 16

Si regull i përgjithshëm, këtu përfshihen sendet me markën e Vodafone me kosto të ulët, të cilët kanë të bëjnë me promovimin, demonstrimin ose shpjegimin e produkteve dhe shërbimeve tonë. Këtu mund të bëjnë pjesë edhe disa ftesa mikpritjeje që bëhen për një qëllim të qartë biznesi, për shembull duke ftuar një grup klientësh të mundshëm në një eveniment që nuk është luksoz ose i tepruar.

Çfarë është dhurata ose përfitimi “i konsiderueshëm ose i pavend”?

Fq. 16

Diçka me vlerë jashtë kufijve monetarë të përcaktuar në Standardin e Politikës së Grupit. Përndrysht, mund të jetë diçka e cila është me vlerë për individin, gjë që mund të japë përshtypjen se është e mjaftueshme për të ndikuar në një vendim biznesi.

Çfarë është “informacioni sensitiv”?

Fq. 21

Informacioni sensitiv mund të përfshijë marrëveshet ligjore, specifikimet teknike ose çdo lloj informacioni tjetër i cili nuk ka gjasa të dihet nga publiku dhe mund të ketë vlerë tregtare.

Çfarë është “informacioni i privilegjuar”?

Fq. 26

Informacion që:

- Është i saktë
- Nuk është bërë publik
- Ka të bëjë me Vodafone
- Nëse bëhet publik, ka të ngjarë të ketë ndikim të konsiderueshmë në çmimin e letrave me vlerë të Vodafone.

Çfarë është “Marrëveshja”?

Fq. 27

Shembujt tipik janë:

- Shkëmbimi i informacionit me konkurrentët, për shembull, lidhur me çmimet, kostot ose volumet e shitjeve
- Të biesh dakord me konkurrentët për të fiksuar çmimin e produkteve ose shërbimeve, duke përfshirë uljet e çmimit, këstet dhe komisionet
- Të biesh dakord me konkurrentët për të mos konkurruar për disa lloje llogarish ose rajonesh, ose të biesh dakord për pjesën e tregut
- Të biesh dakord me shitësit me pakicë për të fiksuar çmimin minimal të shitjeve me pakicë të produkteve ose shërbimeve.

Çfarë nënkuftojmë me “diskriminim”?

Fq. 48

Për këto qëllime, “diskriminimi” përfshin trajtimin më pak të favorshëm bazuar mbi moshën, paaftësinë, seksualitetin, martesës dhe partneritetit civil, shtatzënës dhe lejes së lindjes, racës, fesë ose besimit, dhe orientimit seksual” with “seksualitetin, martesën dhe partneritetin civil, shtatzaninë dhe lejen e lindjes, racën, fenë ose besimin dhe orientimin seksual”

Çfarë nënkuftojmë me “ngacmin” dhe shqetësim”?

Fq. 50

Ne i përkufizojmë ngacminin dhe shqetësimin si sjellje të padëshiruara, nga një person tjetër dhe që janë kërcënuese, keqdashëse, ofenduese, fyese, poshtëruese ose nënçmuese. Këto sjellje mund të kenë lidhje, por nuk kufizohen, me moshën, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, racën, paaftësinë, fenë ose besimin, dhe mund të janë incidente të vetme ose të përsëritura. Këto sjellje mund të janë verbale, joverbale dhe nuk ndodhin gjithmonë ballë për ballë.

Çfarë nënkuftojmë me “të drejta të njeriut”? Eq. 52

Ne i respektojmë të gjitha të drejtat e njeriut të publikuara në nivel ndërkombëtar, duke përfshirë “Deklaratën Botërore të të Drejtave të Njeriut” dhe parimet për të drejtat e njeriut të parashikuara në “Deklaratën për Parimet Themelore dhe të Drejtat në Punë” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Ne përpinqemi të sigurohemi që të mos jemi bashkëfajtorë në shkeljen e të drejtave të njeriut. Në të gjitha kontekstet, ne duhet të përpinqemi të gjemë mënyra për të respektuar parimet e të drejtave të njeriut, të pranuara në nivel ndërkombëtar, madje edhe kur përballemi me kërkesa konfliktuale. Gjithashtu, jemi të angazhuar të zbatojmë “Parimet Udhëzuese për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut” të Kombeve të Bashkuara gjatë ushtrimit të aktivitetit tonë.



Vodafone Group Plc
Vodafone House
The Connection
Newbury
Berkshire
RG14 2FN
England

Tel: +44 (0)1635 33251

© Vodafone Group 2023

ALB